URDHËR
Nr. 15, datë 1.10.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, Kuvendi i Shqipërisë, nëpunësit autorizues, Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, z. Genci Gjonçaj.

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, për Kuvendin e Shqipërisë:

a) Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, z. Genci Gjonçaj, për procedurat e prokurimit publik;

b) Në mungesë të z. Genci Gjonçaj, apo në pamundësi të ushtrimit të kompetencave sipas pikës 2.a, të këtij urdhri, delegohet znj. Merita Qato, drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Legjislativ, për nxjerrjen e akteve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të parashikuara në këtë pikë.

3. Kompetencat e deleguara të titullarit të Kuvendit të Shqipërisë do të ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm në zbatim të këtij urdhri.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Niko Peleshi